



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

Dokument i Komisionit

VENDIM

Nr. 32, datë 16.12.2016

“Për përmbylljen e veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm “Për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”

Bazuar në nenet 24 dhe 32-41 të Regullores së Kuvendit si dhe në Vendimin e Kuvendit nr.55/2016, pika I, “Për një ndryshim në Vendimin e Kuvendit nr.96/2014 “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për reformën në sistemin e drejtësisë”, të ndryshuar, Komisioni :

VENDOSI :

I. Të deklarojë të mbyllur veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për reformën në sistemin e Drejtësisë”.

II. 27 projektligjet e hartuara nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë të shqyrtohen dhe miratohen nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në përputhje me rregullat e parashikuara në Rregulloren e Kuvendit.

III. Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariati Teknik i ngritur në bazë të vendimit të Kuvendit nr.96/2014 dhe vendimeve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për reformën në sistemin e drejtësisë”¹ të vazhdojnë të mbështesin Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, për shqyrtimin dhe miratimin e 27 projektligjeve të hartuara.

IV. Të depozitojë në Arkivin e Kuvendit dokumentacionin e prodhuar nga Komisioni përgjatë veprimtarisë së tij.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Fatmir XHAFAJ

¹ Vendimi nr.2, date 22.12.2014, Vendimi nr.3, datë 22.12.2014, Vendimi nr.4.datë 22.12.2014, Vendimi nr.7, datë 23.01.2015 dhe vendimi nr.8, datë 23.01.2015

